



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRI

Nr. 1539/prot.

Tiranë, më 30/04/2020

URDHËR

Nr. 286, datë 30.04.2020

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193 DATË 20.03.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

Në Urdhrin nr.193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë të pikës 3 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Përjashtim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë të cilat ditën e shtunë 2 maj lejohen të ushtrjnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

2. Në pikën 3/1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Lejohet aktiviteti i taksive për lëvizje ndërqytetase deri në dy pasagjerë, anëtarë të së njëjtës familje, sipas protokolleve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

**Ogerta Manastirliu**

